

RELACION TEKNIK

**"Rikonstruksion i pallatit në bashkëpronësi nr.28 , Rr. Minatori" , Qyteti
Prrenjas.**

Bashkia Prrenjas

Faza Projekt - Zbatim

PERMBAJTJA

1. HYRJE

2. POZICIONI I OBJEKTIT

3. GJENDJA EKZISTUESE

4. OBJEKTIVAT

5. KUSHTETE KLIMATIKE

6. MENYRA E REALIZIMIT TE PROJEKTIT

6.1. Hartimi i projektit

7. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

1. HYRJE

Bashkia e Prrenjasit ndodhet ne juglindje te Republikës së Shqipërisë.Nga pikëpamja gjeografike kjo bashki shtrihet në Krahinë Malore Qëndrore, në pjesën jugore të saj, në fushëgropën e Prrenjasit.

Bashkia e Prrenjasit, ndodhet në rrethin e Librazhdit, në Qarkun e Elbasanit dhe kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Gramsh dhe Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Prrenjasit.

Përrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh.Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë.Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km².Sipas censusit, densiteti i popullsisë është 77 banorë/km² ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 102.279 banorë/km².

2. POZICIONI I OBJEKTIT

Objekti emertohet "Rikonstrukcion i pallatit në bashkëpronësi nr.28 , Rr. Minatori" , ndodhet ne pjesen qendrore te qytetit te Prrenjasit. Objekti është pallat banimi, me 4 hyrje në kat dhe kati i parë shërben për zyrat e Postës Shqiptare dhe Albtelecom sh.a.

Planvendosja e objektit sipas projektit.

3. GJENDJA EKZISTUESE

Objekti është ndërtuar rreth viteve 70.Ky objekt është një objekt i vjetër , tepër i amortizuar. Gjatë inspektimeve dhe matjeve të objektit u vu re që nuk janë kryer ndërhyrje ne konstruksionin e objektit, por janë bërë kryesisht ndërhyrje në fasadën e tij, ku pjesa më e madhe e ballkoneve janë përshtatur në ambinente gatimi.Përsa i përket konstruksionit mbajtës , është prerje mur tulle të plotë 38 cm dhe kollona b/a. Kollonat b/a janë të pranishme në katin e njësive të shërbimit.

Fasadat e jashtme janë të pasuvatuara, përvec katit përdhe qëështë suvatuar nga subjektet që ushtrojnë aktivitet aty.Dritaret janë realizuar pjesa më e madhe me d/alumin tek xham, vetratat e ballkoneve janë d/alumin tek xham, kurse tek kafazi i shkallëve janë tek xham prej druri, duke rritur shumë koeficientët termik të objektit. Tarracat janë të hidroizoluara me dy shtresa katrama të cilat janë riparuar herë pas here nga vetëbanorët .

Pragjet e dritareve janë të amortizuara, po ashtu edhe ato të ballkoneve, duke pasur mundësi të depertimit të ujrave të jashtëm.Të gjitha këto konstatohen edhe duke e parë pallatin nga jashtë.

Dritaret nuk janë pajisur me grila diellore dhe nuk janë aspak uniforme ne ngjyrë, nëformë dhedizanj, madje disa prej dritareve janë mbyllur nga banorët .

Janë 16 apartamente, në katër katet e objektit, dhe sistemi i ndricimit në shumicën e apartamenteve nuk është ekonomik por me llampa të zakonshme me kapacitet afërsisht 100 Ë dhe në të gjithë objektin janë numëruar rreth 90 llampa të tilla.

Të gjitha konstatimet e mësipërme janë realizuar duke e parë në terren objektin dhe duke u konsultuar me banoret.

4. OBJEKTIVAT

Objektivi i përgjithshëm:

Projekti realizohet në kuadër të përgjithshëm të politikave të strehimit dhe në zbatim të nenit 40 te Ligjit .10112 dt.04.09.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë së ndërtesave të banimit" dhe kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për eficensën e energjisë nëpërmjet realizimit të investimeve për eficensen e energjisë.

Objektivi kryesor është aplikimi i kërkesave për rinovimin e ndërtesave egzistuese në bashkëpronësi me qëllim:

- Ndergjegjësimin e bashkëpronarëve për funksionimin e asamblesës bashkëpronarëve sipas ligjit në fuqi.
- Reduktimin e humbjes së energjisë.
- Rritjen e vlerës së ndërtesës.
- Përmirësimin e kushteve të jetesës, rritjen e të ardhurave reale personale.
- Pjesmarrja vullnetare e komunitetit gjate gjithë fazave të projektit, do të sigurojë qëndrueshmërinë e tij.

5. KUSHTET KLIMATIKE

Qyteti i Prrenjasit ndodhet në zonën klimatike mesdhetare paramalore, në nënzonën klimatike mesdhetare paramalore jugore. Temperaturat mesatare vjetore është 11.8⁰ C (varion 10⁰ C - 20⁰ C), e Korrikut është 20.6⁰ C, kurse e Janarit 2.6⁰ C. Minimumi i temperaturës ka arritur -22.4⁰C, dhe kjo shpjegohet me faktin se zona ka një karakter të mbyllur. Ngricat janë një dukuri e zakonshme në këtë qytet.Lagështi varion në varësi të periudhës, në muajin janar arrin 70-75%,

kurse në muajin korrik 45-50%. Reshjet atmosferike në këtë qytet janë të pakta, maksimumi i tyre arrin në stinën e dimrit 310.4 mm dhe mesatarja vjetore e tyre është 889.1 mm. Në këtë qytet fryjnë erëra të flohta nga lindja, nga qafa e Thanës dhe në pjesën jugore dhe perëndimore erërat janë më të ngrohta. Kurse në lidhje me diellëzim, në këtë qytet ka rreth 2400 orë me diell në vit, ku vlera më e lartë arrin në korrik me 320 orë dhe ajo më e ulët në dhjetor me 105 orë.

6. MENYRA E REALIZIMIT TE PROJEKTIT

Projekti do të realizohet në një fazë dhe kjo fazë përfshin të gjitha punimet e llogaritura në preventivin e punimeve.

6.1 Hartimi i projektit

Të gjitha vizatimet janë përpunuar në AUTOCAD dhe do të dorëzohen në CD.

7. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Duke parë gjendjen egzistuese të objektit, është menduar qëky objekt të përmbushë sa më mirë objektivat e këtij projekti të ndërhyhet në këto elemente.

1. Termoizolimi i mureve rrethues te ndërtesës.
2. Termoizolimi dhe hidroizolimi i tarracës së objektit.
3. Zëvendësimi i dritareve dhe vetratave sipas standarteve të eficenses së energjisë.
4. Vendosja e elementeve mbrojtëse të diellit me grilla.
5. Ndricimi me lampa eficiente LED.

- Do të hiqen shtresat e h/izolimit ekzistuese ne tarrace, në soletat e ballkoneve , në oxhaqe, duke përfshirë edhe prishjen e kapakëve të betonit ekzistuese, pasi janë shumë të amortizuar dhe të pjesëve metalike që ndodhen aty dhe transportimi i këtyre materialeve nga kantieri.

- Përvec shtresave hidroizoluese do të prishen edhe të gjitha shtresat e suvasë ekzistuese, duke qënë se një pjesë e madhe e tyre kanë marrë lagështi dhe kanë nevojë për riparim, dhe së dyti sepse objekti do të realizohet sa më uniform.

- Termoizolimi i tarracës do të realizohet duke përdorur materiale termoizoluese (penobeton ose polisterol) të vendosura me pjerrësi në shtresat hidroizoluese.

Muret anësore do të termoizolohen me polisterol kompakt jeshil me trashësi $t= 5 \text{ cm} + \text{rrjet} + \text{suva}$. Polisteroli instalohet nëmur nëpërmjet kollës ngjitëse dhe vidave plastike, duke realizuar edhe një drejtim të sipërfaqes. Pas kësaj vendoset rrjeta plastike, që fiksohet me ngjitës dhe shërben për mbrojtjen nga lagështia. Shtresa e fundit do të realizohet me shtresësuva grafiato.

-Hidroizolimi i tarraces dhe soletave do të realizohet me dy shtresa mapei, e cila do të vendoset mbi shtresën niveluse llac cemento 1-2 me trashësi 2 cm.

-Ulluqet horizontale do të realizohen me pjerrësi 1% për largimin e ujrave, me llamarin xingato me trashësi 0.8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregull me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët së bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale në pjesën e grykës së hyrjes. Ulluku horizontal duhet të jetë i lidhur me tel xingato.

- Ulluqet vertikale që nuk janë në gjendje të mirë do të zëvendësohen me ulluqe të rinj, që do të shërbejnë për shkarkimin e urjave. Ato do të realizohen me llamarin xingat me trashësi jo më pak se 8 mm dhe diametër 100 mm. Do të vendosen në faqet e jashtme të ndërtesës dhe do të fiksohen nëpërmjet fiksueseve prej celiku të xinguar cdo 2 m. Ujrat e tarracës do të kalojnë në ulluqe nëpërmjet llamarinës së xinguar me trashësi 3 mm, me pjerrësi 1% dhe derdhen në kasetën e shkarkimit prej llamarinë xingati me trashësi jo më pak se 8 mm.

- Duke qënë se objekti ka një sipërfaqe të pasuvatuar, në të cilin ka shumë boshllëqe dhe hapësira, të krijuara nga ndërhyrja e banorëve, atëherë fasada e tij fillimisht do të suvatohet me suva të zakonshme, ku sipas rekomandimeve për 1 m^2 do të përdoren 0.005 m^3 rërë e larë lavatrice, 6.6 kg cemento 32.5 N, 0.025 m^3 llac cemento M25 si dhe skelë inventari 1.25 m^2 .

-Sikurse thamë edhe më lart, gjendja e dritareve ekzistuese nuk është e mirë, disa prej tyre nuk dopio xham, nuk kanë një izolim të mirë ndaj ato do të hiqen të gjitha dhe do të zëvendësohen me dritare dopio xham duralumin plastike, dritaret në ambientet e banimit dhe vetratet, kurse dritaret në e jashtme në shkallë do të jenë dritare duralumin tek xham. Dritaret do të përbehen nga materialet PVC sipas standartit ISO EN 9002. Ngjyra e dritareve dhe specifikimet e tyre do të jenë sipas kërkesave të investitorit. Dritaret duhet të sigurojnë në mënyrë perfekte izolimin nga ajri dhe uji. Boshllëku brenda xhamit duhet të jetë 20-24 mm. Dritaret do të pajisen edhe me grila role për mbrojtjen nga dielli.

- Objekti do të lyhet me bojë hidroplastike në pjesën e brendhme dhe në kafazin e shkallëve dhe më bojë hidroplastike cilësi e parë në të gjithë fasadën.

Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke bërë përzierjen e 1 kg vinovil të holluar me 3 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1 litër vinovil i holluar që duhet të përdoret për 20m² sipërfaqe.

Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë akrelik. Kjo bojë ndryshon nga boja plastike sepse ka në përbërjen e saj vajra të ndryshme, të cilat e bëjnë bojën rezistente ndaj rrezeve të diellit, ndaj lagështirës së shirave, etj.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës akrelik me ujë. Lëngu i bojës hollon me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar. Pastaj, bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë akrelik i holluar në 4-5 m² sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyer). Personeli, që do të kryejë lyerjen duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes të KTZ dhe STASH.

-Pragjet e dritareve, vetratave do të jenë pllaka mermeri me trashësi t= 3 cm.

Ndriçuesit neonët dhe pajisjet ndihmëse të prodhuara nga DISANO ILLUMINAZIONE-ITALY ose nga firma të tjera të ngjashme si më poshtë .
Tipi 884EL compact, FLC 2x18 D/E, difuzor i qelqtë, ndezje elektronike, ngjyrë e bardhë.

Ato duhen prodhuar nga fletë të mbuluara me xink ose me fletë çeliku të ngjashme dhe duhen mbërthyer për të formuar një njësi të ngurtë. Lyerja me bojë duhet të jetë e një cilësie të lartë për të parandaluar formimin e ndryshkut sidomos gjatë periudhës së ndërtimit të ndërtesës.

Çdo gërryerje e pjesëve metalike të neonëve duhet ndjekur menjëherë nga një trajtim me kromat zinku i anëve të papërpunuara dhe të lyer me bojë zmalti sintetike me ngjyrë të bardhë.

Deri kur të detajohen në një mënyrë tjetër, ato duhen fiksuar drejt në kutitë hyrëse të kabllove ose linjën e ndriçimit e duhen pasur kujdes për t'u siguruar që ato janë të sigurta aq sa të pranojnë peshën e neonëve.

Ndriçuesit montohen kur të kenë përfunduar të gjitha punimet e ndërtimit dhe të lyerjes. Dëmtimi i neonëve dhe në veçanti dëmtimi nga ndryshku, vjen si rezultat i montimit të parakohshëm. Në raste të tilla supervizori mund të kërkojë heqjen dhe zëvendësimin pa kosto për punëdhësin.

Të gjithë punimet e tjera do të kryhen sipas specifikimeve dhe udhëzimeve të dhëna nga supervizori dhe investitori. Duke ju përmbajtur specifikimeve të dhëna dhe analizave përbri cdo zëri pune.Kujdes duhet patur edhe në punimet e jashtme dhe sistemit duke realizuar gërmimet në nivelin e duhur, hedhjen e shtresës sipas markës së dhenë të betonit M200, duke respektuar recetën e ketij lloj betoni dhe kryerja e provës për arritjen e kësaj marke.Hedhjen e shtresës së rërës dhe vendosjen e pllakave dhe bordurave. Përvec kësaj do të bëhët edhe sistemi i sheshit në hyrjen e mbrapme të pallatit, në të cilin është parashikuar germime dhe nivelim te sheshit në një gjerësi prej 4 m dhe gjatësi nga pjesa e shtruar e deri në daljen e trotuarit në pjesën perëndimore të pallatit. Pas nivelimit të sheshit do të hidhet shtresë betoni C 16/20

Ing. Gjyladin Polisi

